



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 33, Datë 28.02.2022

MBI

**MOS FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“ENERGY FINANCING TEAM TIRANA” SH.P.K., ME NR. 390 SERIA F17 NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 174, DATË 26.10.2017**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 263/4 prot., datë 21.02.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., me Nr. 390, seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 26.10.2017”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., mbajtëse e licencës nr. 390, Seria F17, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike që nga data 26.10.2017, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 119, me shkresën e protokolluar në ERE nr. 250 prot., datë 10.02.2022, ka paraqitur kërkesën për të rinovuar licencën në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; Dokumentacionin financiar dhe fiskal dhe Dokumentacionin teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike.

- Nga aplikimi është konstatuar mungesë e theksuar e dokumentacionit si vijon:

Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2:

- **gërma “d”** (*Vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë*). **Plotësuar pjesërisht**. Mungojnë vërtetimet e gjykatës dhe prokurorisë për shoqërinë dhe administratorin.
- **gërma “e”** (*Struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse*). **Plotësuar pjesërisht**. Mungon Struktura në formë skematike dhe çdo dokument që disponon (marrëveshje/kontratë) në lidhje me shërbimin që ofron për këtë veprimtari grupi inxhiniero-teknik i kompanisë mëmë.

Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3:

- **gërma “a”** (*Vërtetim për shlyerjen e Tatim - Taksave dhe detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore*) **Plotësuar pjesërisht**. Mungon vërtetimi për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
- **gërma “b”** (*Bilanci financiar i tre viteve të fundit*). **Plotësuar pjesërisht**. Mungojnë pasqyrat financiare të audituara për vitin 2018.
- **gërma “c”** (*Dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit*) **Pa plotësuar**. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë.

Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike. Neni 9, pika 4.7:

- **gërma “b”** (*Kapitali financiar (i shprehur në vlera monetare) i parashikuar për ushtrimin e kësaj veprimtarie, i shoqëruar me vërtetim nga banka apo institucione të tjera financiare të njohura me ligj*); duhet të dokumentojë se cili është kapitali financiar i parashikuar për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike. **Pa plotësuar**. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë.
- **gërma “e”** (*Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi*). **Pa plotësuar**. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë.
- **gërma “g”** (*Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve*). **Pa plotësuar**. Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë të rregullores.

- **gërma “i”** (Niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët.) **Pa plotësuar.**
Mungon dokumentacioni sipas kësaj kërkesë të rregullores.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për rinovimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike bazuar në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjise elektrike”*, e ndryshuar.
- Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të mos fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 390 Seria F17, të shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, data 26.10.2017.
2. Në rast se shoqëria do të paraqesë një aplikim të ri, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e këtij vendimi të bordit të ERE-s, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të rinovimit të licencës do të konsiderohet i vlefshëm.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI